



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSION DHE MIRËMBAJTJE LERASH PËR  
BLEGTORINË”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime  
ndërtimi për rezervuarë 45247270-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9,428,710.8** (nëntë milion e katërqindë e njëzetë e tetë mijë e  
shtatëqindë e dhjetë presje tetë lekë) **pa TVSH**

**Perillogaritja e fondit limit** dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

## **2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në pikën 2,b të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë vlerën e përllogaritur të kontratës.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për

procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatoret ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

**a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike:** Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- v. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

**b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat:** Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të

pershtatshem cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatorët ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervojë qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuarën dhe pikës 5 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim te konkurrenaces.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 39,pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve te ndërtimit”,Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës per te vertetuar kerkesat e percaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes , situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim për punët e kryera me entet publike, qe Autoriteti Kontraktor te bindet qe operatori ekonomik me ane te dokumentacionit te paraqitur ploteson kriterin per pune te ngjashme ku shihen zerat e punimeve qe ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit si dhe vleresimi i dhene nga Autoriteti Kontraktor,elemente te nevojshem per te gjykuar per plotesimin e kriterëve per pune te ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

**2.3.2** Operatorët ekonomike duhet te deshmojne se disponojne license profesionale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe per kategorie te nevojshme per zbatimin e kontrates.

Per kete duhet te paraqesin licensen perkate se te shoqerise, bazuar neformatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi*”, I ndryshuar.

Licënca profesionale e shoqërise,e vlefshme, me kategoritë:

- **N.P-1A** (Punime gjërmimi);
- **N.P-5A** (Punime nentokesore ura dhe vepra arti ).
- **N.S-18A** (Punime topogjodezike)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

| Kategoria e kërkuar    | Pershkrimi                            | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv |
|------------------------|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|
| <u>Kategoria NP-1</u>  | Punime germimi                        | Punime germimi sipas preventivit                                                               | Niveli A                                                  | 0-20 mln                                                |
| <u>Kategoria NP-5A</u> | Punime nentokesore ura dhe vepra arti | Ura tombino vepra arti                                                                         | Niveli A                                                  | 0-20 mln                                                |
| <u>Kategoria NS-18</u> | Punime topogjeodezike                 | Është e nevojshme për piketimin e objektit sipas kuotave të projektit                          | Niveli A                                                  | 0-20 mln                                                |

**2.3.3** Ofertuesi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve dhe e stafit të jetë jo më pak se **30** punonjës për 3 muajt e fundit. Për përmbushjen e kësaj pike, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e lartëpërmendur.
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Bazuar në analizat e cmimeve për zërat e preventivit ku për çdo zë jepen orët e punës të nevojshme, makineritë që kërkohen në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**2.3.4** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- **Inxhinier Ndërtimi Profili Strukture** **1 (një)**
- **Inxhinier Gjeodet** **1 (një)**

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune,
- Diplomën Universitare,

Drejtuesit teknik të projektit të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar

Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e punimeve në përputhje me zerat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese në licencën perkatese të zbatimit, Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.

Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt.

Inxhinieri gjeodet është i nevojshëm për zbatimin korrekt të objektit duke e piketuar sipas kuotave të projektit.

**2.3.5** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të kenë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit sipas kodit të profesionit të paktën **muajin e fundit**, punonjesit specialistë të kualifikuar, të vertetuar me dëshmi kualifikimi profesionale, diploma ose çertifikata të shkollës profesionale perkatese për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licensuara nga organet perkatese, kontrate pune individuale ose të kontraktuar në rastin kur makineritë janë me qira (për manovratorët), me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë si më poshtë:

|                       |                |
|-----------------------|----------------|
| - <b>Murator</b>      | <b>3 (tre)</b> |
| - <b>Karpentier</b>   | <b>2 (dy)</b>  |
| - <b>Betonues</b>     | <b>4 (dy)</b>  |
| - <b>Hekurkthyes</b>  | <b>1 (një)</b> |
| - <b>Manovrator</b>   | <b>1 (një)</b> |
| - <b>Automakinist</b> | <b>1 (një)</b> |
| - <b>Automakinist</b> | <b>1 (një)</b> |

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe vëllimet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në si dhe mjetet të kërkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

Kërkesa që punonjesit e me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të

punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar Kërkesa për deshmite të manovratoreve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

**2.3.6** Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

| Nr. | Mjete/pajisje teknike                                                                                                                                                                                                     | Sasia  | Statusi                                   |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------------------------------------------|
| 1   | Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 10 tonë                                                                                                                                                                 | 1 copë | Në pronësi ose me qira                    |
| 2   | Kamioncine 3.5-5 ton                                                                                                                                                                                                      | 1 copë | Në pronësi ose me qira                    |
| 3   | Autobetoniere kantieri (Mjet teknologjik)                                                                                                                                                                                 | 1 copë | Në pronësi ose me qira                    |
| 5   | Eskavator me zinxhir gome                                                                                                                                                                                                 | 1 copë | Në pronësi ose me qira                    |
| 6   | Autovinç me kapacitet ngritës mbi 3 ton                                                                                                                                                                                   | 1 copë | Në pronësi ose me qira                    |
| 8   | Fadromë me goma (Mjet teknologjik)                                                                                                                                                                                        | 1 copë | Në pronësi ose me qira                    |
| 14  | Fabrikë për prodhimin e betonit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Leje Mjedisore Kodi III.1B, certifikate cilesie ISO 9001- 2015 ( e vlefshme) e vendosur jo më larg se 50 km nga objekti . | 1 copë | Në pronësi / me qira / kontrate furnizimi |
| 16  | Fabrikë për prodhimin e materialeve inerte, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Leje Mjedisore Kodi III.1B , Leje minerare).                                                                   | 1 copë | Në pronësi / me qira / kontrate furnizimi |

**2.3.6.1** Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30(Njëzetë e pesë) copë
- Jelekë minimumi 30 (Njëzetë e pesë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 1 (Një) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 3 (tre) copë
- fikse zjarri të levizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 (dy) copë;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:
  - certifikatën e pronësise;
  - leja e qarkullimit;
  - siguracionin;
  - certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);

- taksat vjetore

- leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;

ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve si dhe fotografi.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve si dhe fotografi.
- Për pajisjet duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për pajisje të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Makineritë janë vendosur bazuar në zërat e preventivit dhe proceseve të punës për realizimin me sukses të veprës.

### 2.3.7 Për të përmbushur kërkesat e cilësisë në zbatim të legjislacionit në fuqi:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë mbi sistemet e menaxhimit të ambientit **ISO 14001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë **OHSAS 18001 / ISO 45001 (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Certifikatat të jenë në gjuhen shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

**Argumentimi:** Në zbatim të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim:

Të gjitha dokumentat e kërkuara, provuese të kapaciteteve që deklarohen në shtojcën 8, nuk është e nevojshme të paraqiten në fazën e ofertimit në zbatim të nenit 82 të LPP dhe pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit është e detyrueshme të paraqiten para lidhjes së kontratës për operatorin e shpallur fitues por dhe nëse autoriteti kontraktor kërkon sqarime apo dokumente provuese gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Specifikimet teknike janë hartuar nga projektuesi dhe janë pjesë e dosjes teknike**

*Specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**